



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2020

**V E N D I M**

**Nr. 91, Datë 17/08/2020**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 88, datë 07.08.2020, e z. A.Dh., ku pretendohet për diskriminim “për çdo shkak tjetër”, nga ana e Bconnect sh.p.k.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit të dërguar nga ankuesi, rezulton se z. A.Dh. është punonjës pranë kompanisë Bconnect sh.p.k. (call center) prej 6 vitesh. Marrëdhëniet e punës janë rregulluar nëpërmjet Kontratës Individuale të Punës, së lidhur në mars të vitit 2014. Duke filluar nga muaji nëntor 2019, ai është caktuar të punojë në fushatën Fastëeb PreMVNO. Ankuesi sqaron se që prej vitit 2016 ka punuar 40 orë në javë.

Për sa më sipër, ai shprehet se nga muaji korrik 2020, atij i është imponuar nga kompania që të punojë në ambientet e saj dhe jo në shtëpi sikurse punojnë punonjësit e tjerë, pavarësisht kundërshtimeve të tij. Njëkohësisht, ai thekson faktin se është i vetmi punonjës nga personat që punojnë në fushatën Fastëeb PreMVNO, që ka sasinë më të vogël të orëve të punës (16 orë),

ndërkohë që kolegët e tij punojnë me orar të plotë prej 40 orësh. Ai sqaron se është ankuar dhe ka kërkuar të punojë me orar të plotë, sikurse kolegët e tij, por një gjë e tillë është refuzuar nga shoqëria me arsyetimin se nevoja e saj është që ai të punojë me këtë sasi orësh pune. Në këtë kontekst, ai shprehet se ndihet i diskriminuar nga kjo shoqëri, pasi ndarja orare e punës duhet të jetë e barabartë.

#### **A. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri.**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 88, datë 07.08.2020, së z. A.Dh., Komisioneri vlerësoi se ankuesi duhet të identifikonte shkakun e diskriminimit të tij, pasi në formularin e ankesës së plotësuar nga z. A.Dh. ishte shënuar opsioni “për cdo shkak tjetër”, pa përcaktuar se cili ishte ky shkak.

Për këtë arsye, nëpërmjet e-mailit zyrtar, KMD iu drejtua në datën 08.10.2020, z. A.Dh. me kërkesë për informacion, duke i kërkuar të identifikonte shkakun e diskriminimit të tij nga shoqëria Bconnect sh.p.k. Në e-mail u theksua fakti që informacioni i kërkuar duhej dërguar brenda datës 11.08.2020.

Ankuesi nuk i dërgoi përgjigje e-mailit të Komisionerit.

#### **Në këto kushte, Komisioneri gjykon se:**

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ofron mbrojtje nga diskriminimi ndaj të gjithë personave fizikë/juridikë, duke parashikuar një listë jo shterruese shkaqesh. Në nenin 1 të tij parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, raçën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozitë gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Referuar përmbajtjes së kësaj dispozite, rezulton tepër e qartë dhe evidente, që të gjitha shkaqet e sipërpërmendura, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësi, apo karakteristika individuale të personave që pretendojnë për diskriminim. Situata diskriminuese në vetëvete është gjithmonë e lidhur me një veçori individuale të viktimës dhe në rastin konkret, ankuesi A.Dh. nuk ka identifikuar një shkak të vlefshëm diskriminimi, që të ketë lidhje me një nga karakteristikat e tij personale, por ka shënuar opsionin “për çdo shkak tjetër”. Në mungesë të shkakut të diskriminimit, Komisioneri gjykon se nuk disponon informacion të mjaftueshëm për të kryer hetim për rastin konkret.

Në këtë kontekst, referuar gërmës ç), pika 4, neni 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”<sup>1</sup>, Komisioneri gjykon se për ankesën nr. 2, datë 03.01.2018, e Z. A.Dh. nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 7, 12-13, 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 88, datë 07.08.2018, të z. A.Dh..
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONERI  
NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**DREJTORE JURIDIKE**

**Ardiana HALA**

Fusha – punësim  
Shkak – cdo shkak tjetër  
Lloji i vendimit - mospranim

---

<sup>1</sup>Gërma ç), pika 4, neni 33, i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon: “Ankesa nuk pranohet nëse: .....ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”.